



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2022

Lënda: Kthim përgjigje

Z. _____

I nderuar ,

Në vijim të shkresës Suaj datë 18.01.2022, të administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 926 dt. 19.01.2022, Ju informojmë si më poshtë vijon:

Referuar dokumentave strategjike që Bashkia Shkodër disponon dhe direktivave të PPK dhe PINS bregdet, synojmë që deri në vitin 2030 Shkodra të ketë një ndarje ambicioze ndërmjet formave të ndryshme të transportit 30% biçikleta, 25% transport publik, 25% këmbësorë dhe 20% makina individuale.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) parashikon korsitë e biçikletave për çdo aks kryesor. Kështu që për çdo rikonstruksion apo ndërtim të çdo aksi është ndërtuar edhe korsia përkatëse. Po ashtu mbi bazën e këtij dokumenti është përgatitur edhe Plan-Studimi i Trafikut dhe Lëvizshmërisë, i cili parashikon menaxhimin e rrugëve ekzistuese, duke rimodeluar përdorimin e tyre me më shumë hapësira për biçikleta. Mirë po duke qenë se levizshmëria urbane është komplekse dhe përshin edhe problematikat e levizjes me makina, në veçanti menaxhimin e parkingjeve, Bashkia Shkodër është duke hartuar Planin e menaxhimit të parkingjeve.

Qendra e Shkodrës është e zhvilluar në një zonë me rreze 500 m ndërsa i gjithë qyteti i Shkodrës është zhvilluar në një rreze prej 1.5 km. Bazuar në llogaritjet e bëra nga ekspertë të fushës, shpejtësia e ecjes është rreth 5 km/h dhe shpejtësia e biçikletës është 12-15 km/h, koha e ecjes është nga 6-18 minuta dhe koha e ecjes me biçikletë nga 2,5-7,5 minuta në rast.

Sa më sipër, ju informojmë se ka rrugë funksionale për biçikleta. Rrjeti ekzistues i korsisë së biçikletave është rreth 23 km. Ky rrjet përbehet nga rrjeti i brendshëm dhe ai i jashtëm. Rrjeti i brendshëm përbëhet nga akset e mëposhtme:

- Ura e Bunës-Sheshi Xhabije
- Bulevardi Zogu i Parë
- Rruga Mehmet Pashë Plaku
- Rruga Daut Borici
- Unaza Lindore
- Unaza Perëndimore
- Rruga Shkodër- Shirokë

Në hartën bashkëlidhur shkresës gjeni rrjetin e biçikletave.

Krahas rrjetit të brendshëm në qytet bashkëlidhur shkresës gjeni dhe një broshurë informative mbi mundësitë e udhëtimit me biçikletë për dashamirësit e saj që bëjnë të mundur aksesimin e zonave turistike të Bashkisë Shkodër dhe rajonit përreth. Dokumenti ofron një informacion të detajuar për distancën, hartën shkallën e veshtrësisë, etj.

Në 5 vitet e fundit janë shtuar korsitë e biçikletave në aksin e By-Passit përgjatë liqenit të Shkodrës në një gjatësi rreth 5 km për secilin kah lëvizjeje..

Bashkia Shkodër nuk ka kryer financim direkt vetëm për korsitë e biçikletave. Në kuadër të punimeve të mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit, te sistemit të rrugëve, pjesë e projekteve të tyre ka qenë edhe krijimi i korsive të biçikletave nepërmjet hapjes dhe markimit me sinjalitike të tyre.

Së shpejti do të shtohet edhe korsia e biçikletave përgjatë liqenit (aksi Shirokë – Zogaj), kjo e integruar në projektin e rikonstruksionit të plotë të rrugës.

Të gjitha të dhënat e listuara më sipër janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër: www.bashkiashkoder.gov.al

Duke Ju falenderuar!

KRYETAR

Voltana Ademi

